



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 2799 Prot.

Tiranë, më 22/06/2026

**Lënda:** Kërkesë për zhvillimin e një Mocioni me Debat

**Drejtuar:** **Z. Niko PELESHI**  
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

**Baza Ligjore:** Neni 98 i Rregullores së Kuvendit

*I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,*

Sikurse jeni në dijeni, në datën 17 Qershor 2026, Parlamenti European ka miratuar Rezolutën P10\_TA(2026)0217 “Mbi raportin e Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur. Kjo Rezolutë përfshinë çështje me interes publik, që do duhet të adresohen nga Kuvendi i Shqipërisë.

Janë të rëndësishme të theksohen, se ndër të tjera, 20 shqetësimet e mëposhtme të evidentuara nga Parlamenti European, kërkojnë një trajtim të menjëhershëm nga Kuvendi i Shqipërisë. Konkretisht, në Rezolutë, ndër të tjera, Parlamenti European:

- 1. Përsërit shqetësimet lidhur me mungesën e barazisë së kushteve për aktorët politikë, keqpërdorimin e burimeve administrative që zbeh kufijtë mes institucioneve shtetërore dhe strukturave partiake, financimin e partive politike, akuzat për blerje votash dhe presionin mbi votuesit. Prandaj, i bën thirrje shumicës qeverisëse dhe opozitës në Shqipëri të ndjekin në mënyrë konstruktive dhe gjithëpërfshirëse një reformë të gjerë zgjedhore, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, si dhe të zbatojnë plotësisht rekomandimet e papërmbushura të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias shumë përpara cikleve të ardhshme zgjedhore. Thekson se një reformë e tillë duhet të forcojë kuadrin zgjedhor, përfshirë transparencën e financimit të fushatave, aksesin e barabartë në media dhe masat mbrojtëse kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, si dhe të sigurojë zbatimin efektiv të këtij kuadri. Nënvizon se konsensusi i gjerë politik dhe zbatimi real i këtyre reformave janë thelbësore për garantimin e besimit publik në zgjedhjet e ardhshme.*
- 2. Shpreh shqetësim për polarizimin e vazhdueshëm politik dhe diskursin konfrontues politik, të cilat dëmtojnë mbikëqyrjen parlamentare, besimin e publikut dhe funksionimin efektiv të institucioneve demokratike. Inkurajon aktorët politikë të rikthehen në dialog konstruktiv parlamentar, duke siguruar që Kuvendi i Shqipërisë të mbetet forumi kryesor për debat demokratik dhe kontroll demokratik. Nënvizon se një demokraci funksionale kërkon pjesëmarrje kuptimplotë të opozitës në procedurat parlamentare.*
- 3. Nënvizon se mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit mbetet thelbësore për shtetin e së drejtës, krahas përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar më tej llogaridhënien, cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor. Megjithatë, vëren sfida të vazhdueshme lidhur me efikasitetin gjyqësor, zbatimin efektiv të vendimeve përfundimtare të gjykatave,*

- grumbullimin e çështjeve të pazgjidhura, konsistencën e jurisprudencës dhe përpjekjet për të ushtruar ndikim të padrejtë.
4. Kujton se imuniteti parlamentar është pjesë e kuadrit kushtetues të Shqipërisë, i projektuar për të siguruar funksionimin e duhur të institucioneve demokratike. Thekson se çdo vendim në këtë drejtim duhet të merret në përputhje të plotë me dispozitat kushtetuese dhe procedurat ligjore të vendosura, pa ndërhyrje politike dhe pa vonesa të pajustificuara.
  5. Bën thirrje për forcimin e mëtejshëm të organeve të qeverisjes gjyqësore dhe për investime të qëndrueshme në infrastrukturën gjyqësore dhe digjitalizim. Kujton se gjyqësori vazhdon të përballet me presione dhe kërcënime politike që rrezikojnë të minojnë pavarësinë e tij. Nënvizon rëndësinë e zbatimit në kohë dhe të plotë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ, si element thelbësor i shtetit të së drejtës dhe balancës institucionale.
  6. Shpreh keqardhje që, sipas renditjes së publikuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2025 nga Transparency International, Shqipëria ka rënë në vendin e 91-të, krahasuar me vendin e 80-të në vitin 2024. Thekson se korrupsioni mbetet një shqetësim serioz dhe se, pavarësisht progresit në kuadrin ligjor dhe institucional, Shqipëria duhet të rrisë më tej kapacitetet e saj policore të dedikuara dhe të konsolidojë rezultatet në hetime, ndjekje penale dhe dënime përfundimtare, veçanërisht në rastet e korrupsionit në nivele të larta. ....kërkon garantimin e pavarësisë së SPAK, burimeve të mjaftueshme dhe kapaciteteve operative, pa kufizuar kompetencat hetimore apo cenuar punën e tyre. Gjithashtu kërkon forcimin e përpjekjeve për identifikimin, ngrirjen, konfiskimin dhe administrimin efektiv të pasurive kriminale.
  7. Këmbëngul se korrupsioni duhet të luftohet në të gjitha nivelet për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucionet shtetërore dhe për të krijuar një mjedis biznesi të parashikueshëm. Kërkon forcimin e transparencës, kontrollit të konflikteve të interesit, vlerësimeve të rrezikut të integritetit dhe masave parandaluese në sektorët me risk të lartë, veçanërisht në prokurimet publike, koncesionet, licencimet, inspektimet dhe planifikimin urban.
  8. I bën thirrje Shqipërisë të bëjë përparim vendimtar në regjistrimin fillestar të pronave dhe në kompensimin e drejtë e të pranuar gjerësisht, të përmirësojë transparencën e regjistrimit shtetëror të pronave dhe cilësinë e të dhënave kadastrale, si dhe të garantojë respektimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe mbrojtje efektive gjyqësore në rastet e shpronësimit dhe largimit nga pasuria e paluajtshme.
  9. Thekson rëndësinë e luftës efektive kundër krimit të organizuar, përfshirë pastrimin e parave dhe trafikun e drogës, dhe kërkon bashkëpunim më të ngushtë me agjencitë e BE-së si Europol dhe Eurojust. Gjithashtu kërkon përshpejtimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në këtë fushë.
  10. Kërkon përpjekje të mëtejshme për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit mediatik, përfshirë transparencë më të madhe mbi konfliktet e mundshme të interesit të pronarëve të mediave, mbrojtje kundër presioneve politike dhe ekonomike mbi gazetarët dhe hetim efektiv të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj tyre.
  11. Dënon ashpër armiqësinë ndaj gazetarëve të pavarur dhe profesionistëve të medias në Shqipëri, përfshirë sulmet verbale dhe retorikën kundër mediave nga zyrtarë të lartë, fushatat e diskreditimit dhe ngacmimet mizogjene online. Shpreh gjithashtu shqetësim për numrin e lartë të padive kundër gazetarëve. ... shpreh keqardhje që ndryshimet e fundit në Kodin Penal nuk kanë çuar në dekriminalizimin e plotë të shpiffes dhe fyerjes sipas standardeve të BE-së dhe atyre ndërkombëtare.

12. *Thekson se nevojiten përpjekje të mëtejshme për rekrutim të bazuar në meritë dhe depolitizimin e shërbimit civil.*
13. *Shpreh shqetësim se kuadri ligjor për prokurimet publike dhe legjislacioni për shoqëritë tregtare nuk janë ende plotësisht të harmonizuara me acquis të BE-së. Kërkon vazhdimin e përpjekjeve për përafrim të plotë dhe forcimin e mbikëqyrjes parlamentare, auditimeve të pavarura dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.*
14. *Kërkon zbatimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte, si një nismë strategjike për mbrojtjen e interesave kombëtare të Shqipërisë, rritjen e sigurisë dhe garantimin e parashikueshmërisë për investitorët në përputhje me standardet e BE-së.*
15. *Thekson se sistemi i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Shqipëri mbetet vetëm pjesërisht efektiv. Kërkon rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së ndërmarrjeve shtetërore përmes publikimit të raporteve vjetore financiare dhe zbatimin e plotë të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.*
16. *Shpreh keqardhje të thellë për faktin se Ligji i Shqipërisë për Investimet Strategjike i vitit 2015 është zgjatur, duke pasur parasysh se dispozitat e tij mundësojnë procedura të përsheptuara të dhënies së lejeve dhe reduktim të kontrollit mjedisor, gjë që rrezikon të ketë ndikime negative mbi zonat e mbrojtura dhe zona të tjera me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Kërkon shfuqizimin e ndryshimeve të vitit 2024 në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, të cilat lejojnë zhvillimin e infrastrukturës turistike në shkallë të gjerë brenda zonave të mbrojtura dhe transferojnë kompetenca kyçe të qeverisjes dhe vendimmarrjes të Këshilli Kombëtar i Territorit, duke dobësuar kështu mbikëqyrjen mjedisore.*
17. *Thekson se Komisioni Evropian e ka paralajmëruar Shqipërinë kundër veprimeve që mund të ndikojnë negativisht në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në kushtet e protestave të vazhdueshme kombëtare lidhur me një projekt zhvillimi luksoz në shkallë të gjerë, i cili kërcënon një zonë të mbrojtur natyrore ku jetojnë flamingot, fokat dhe ku ndodhen vende folezimi të breshkave. Mbështet kritikën e Komisionit në këtë drejtim dhe kujton se përafrimi me legjislacionin mjedisor të Bashkimit Evropian, përfshirë Direktivën për Shpendët dhe Direktivën për Habitatet, është një kusht paraprak për anëtarësimin në BE.*
18. *Shpreh shqetësim serioz se zhvillimet në vazhdim brenda zonës së mbrojtur Vjosë–Nartë tregojnë pasojat konkrete të këtyre ndryshimeve ligjore dhe rreziqet që ato sjellin për zonat me vlera të njohura ekologjike. Ndjek nga afër protestat masive dhe paqësore që po zhvillohen në këtë kuadër. I bën thirrje autoriteteve shqiptare që të vendosin menjëherë një moratorium për të gjitha procedurat e reja të lejeve, punimet ndërtimore dhe ndërhyrjet zhvillimore brenda zonave të mbrojtura, derisa dispozitat e papajtuashme të Ligjit të ndryshuar për Zonat e Mbrojtura të jenë shfuqizuar, në përputhje me kërkesat e kahershme të Komisionit dhe Parlamentit Evropian dhe në linjë me standardet përmbyllëse të Kapitullit 27, si dhe derisa të garantohet përputhshmëria e plotë me standardet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e natyrës. Nënvizon se çdo projekt në këtë zonë duhet t'i nënshtrohet vlerësimeve të plota të ndikimit në mjedis, në përputhje të plotë me standardet e BE-së, duke përfshirë një proces transparent konsultimi publik me komunitetet lokale, shkencëtarët dhe shoqërinë civile.*
19. *Paralajmëron se nismat e zhvilluara jashtë kuadrit të Bashkimit Evropian, përfshirë nismën “Open Balkan”, rrezikojnë të krijojnë struktura paralele që mund të minojnë Procesin e Berlinit dhe Tregun e Përbashkët Rajonal të Ballkanit Perëndimor.*
20. *Shpreh shqetësim për parregullsitë serioze të identifikuara nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) në zbatimin e programit IPARD II në Shqipëri. Nënvizon rëndësinë*

*e garantimit të transparencës së plotë, llogaridhënies dhe mekanizmave efektivë të kontrollit në përdorimin e fondeve të BE-së, për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe për të ruajtur besimin publik. Kërkon zbatimin e menjëhershëm të masave korigjuese të nevojshme.*


Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 98 të Rregullores së Kuvendit, ku parashikohet se “një kryetar grupi parlamentar mund të paraqes një mocion me debat për çështje të vecantë”, kërkohet zhvillimin e një debati mbi Rezolutën P10\_TA(2026)0217 të Parlamentit Evropian “Mbi raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025”. Koha e përgjithshme e debatit të jetë jo më shumë se 10 minuta për secilin deputet që dëshiron të diskutojë, duke qenë se integrimi evropian është përcaktuar në nisje të kësaj Legjislature si prioritet absolut i Kuvendit të Shqipërisë.

Përsa më lart, kërkohet mbledhje e Konferencës së Kryetarëve në datën 23 Qershor 2026 dhe përfshirjen e kësaj çështje në rendin e ditës të seancës plenare të datës 25 Qershor 2026, nisur nga fakti që në Kalendarin e Punimeve të Kuvendit nuk është parashikuar shqyrtimi i çështjeve të tjera në këtë datë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

## **GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE**

**Gazment BARDHI**



**KRYETAR**